



KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 49, datë 31.05.2017

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK TË TIRANËS
NR. 84, DATË 29.12.2016, PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM
2017-2019 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2017 (I
NDRYSHUAR)”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja (b) e pika 1/1.3, shkronja (c), nenit 34, pika 6, nenit 40, pika 4, nenit 54, shkronja dh) dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2016 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 113, të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 7776, datë 22.12.1993 “Për buxhetin lokal” (i ndryshuar); nenit 44, paragrafi i dytë, shkronja (a) të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 për “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”(i ndryshuar); Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.8 datë 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84 datë 29.12.2016 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”(i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Vendimi Nr.84, datë 29.12.2016 i Këshillit Bashkiak të Tiranës “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”(i ndryshuar), ndryshohet si më poshtë:

1. Shpërndarjen e Financimit për projekte të reja nga FZHR për vitin 2017 në programin “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale” në shumën 73,499,096 lekë dhe në programin e Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit në shumën 179,036,513 lekë sipas pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë detajimin e fondeve të Transfertës Specifike për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të investimeve dhe shpenzimeve operative brenda Programit të Shërbimeve Publike Vendore dhe Programit të Strehim Planifikim Territorit për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të investimeve brenda Programit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik, Shërbimeve Publike Vendore dhe Strehim Planifikim Territori për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

5. Të miratojë ndryshimin e emërtimeve të objekteve për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 5, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
6. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të investimeve brenda Programit të Kujdesit Social, Rendit dhe Mbrojtjes dhe Strehim Planifikim Territori për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 6, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
7. Të miratojë detajimin e fondit të projekteve brenda Programit të Kujdesit Social për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 7, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
8. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të investimeve brenda Programit të Strehimit dhe Planifikimit të Territorit për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 8, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
9. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të shpenzimeve brenda Programit të Emergjencës Civile për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 9, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
10. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të shpenzimeve dhe investimeve brenda Programit të Shërbimeve Publike Vendore, Planifikim, Menaxhim, Administrimit dhe Strehim Planifikim Territori për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 10, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
11. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Agjensia e Parqeve dhe Rekreacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit për zbatimin e këtij vendimi
12. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI